

EPPC Albania kërkon një *Recruitment & Talent Officer* për klientin e saj, **NJË NDËR KOMPANITË MË TË MËDHA NË NIVEL GLOBAL** e cila operon në fushën e përkthimeve.

Kandidati ideal do të asistojë në procesin e rekrutimit dhe do të jetë përgjegjës për procesin e plotë të përzgjedhjes: rekrutim, vlerësim dhe testim të talenteve sipas nevojave dhe kërkesave të kompanisë në nivel global.

Përgjegjësitë Kryesore:

1. Planifikon dhe organizon në mënyrë proaktive procesin e rekrutimit të talenteve duke vlerësuar, intervistuar dhe punësuar kandidatët e kualifikuar;
2. Përshtat dhe publikon njoftimet e punës sipas profileve të kërkuara;
3. Identifikon kanalet më efektive të rekrutimit me qëllim zgjerimin e databesës së kandidatëve sipas nevojave të kompanisë;
4. Kujdeset për mirëmbajtjen e databesës së kandidatëve/talenteve;
5. Ofron mbështetje për shpërndarjen e talenteve të kualifikuar në varësi të natyrës së secilit projekt dhe brenda buxhetit të alokuar;
6. Përdor burime, mjete dhe teknika të ndryshme tradicionale dhe inovative në identifikimin dhe tërheqjen e kandidatëve potencial.
7. Përgatit kontratat dhe raporton tek drejtuesit për ecurirën e punës në mënyrë periodike.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- Përvojë e mëparshme pune **në pozicione të ngjashme në HR;**
- Të **zotërojë shumë mirë Gjuhën Angleze** në të shkruar dhe të folur (*domosdoshmëri*);
- I/e aftë të ndërtojë raporte pozitive pune dhe të komunikojë në mënyrë efektive dhe të qartë me kolegët brenda dhe jashtë në nivel grupi;
- Të punojë nën presion, të jetë i orientuar drejt detajeve dhe zgjidhjes së problemeve;
- Aftësi të mira të menaxhimit të kohës, prioriteve dhe arritjes së objektivave.

Të dhënat:

Vendndodhja:	Qendër, Tiranë;
Orari:	40 orë në javë;
Kontrata:	Kontratë me periudhë të përcaktuar, por me të drejtë rinovimi.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj **deri në datë 21.08.2019** në linkun që vijon:

[https:// aplikim.eppc.al](https://aplikim.eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.